

NACIONAL

Gazeta e përditshme online:
www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Flet për "Nacional" studiuesi,
Prof. dr. Shaban Sinani

Cikli mitologjik në vepren e Kadaresë


Intervistoi: Albert Zholi faqe 2-3



Kote si gazetar dhe publicist, por edhe
lëvrues i poezisë, tregimit, novelës, etj

Kur je shkrimtar, kufijtë e gjithësisë zgjerohen para teje

Studim nga Dr. Gjekë Marinaj faqe 6-7



EDITORIAL

Identiteti politik

Me sytë nga Amerika

Nga Mujë Buçpapaj



"Për një vend si Shqipëria e cila shpesh zhytet në kriza dhe konflikte ciklike, duke vënë përpara provazh vendimarrëse jo vetëm udhëhqjen e saj politike, por edhe popullin e saj, Historia e Amerikës është një model i mbijetesës së demokracisë parimore që ushqehet nga një popull i përkushtuar..."

Faqe 15

Reagimi

Një formular antishqiptarë

Nga Beqir Sina



"Konsulli grek Theodoros Ikonomu, koherentë dhe në të njëjtën linjë me ultranacionalistët e shovinistët grekë në Shqipëri dhe disaporën greke, ka hapur një çështje që ata nuk i "zë gjumi". Ai ka përshëndetur "greqët e Korçës", me gjuhën kryepeshkopit të gjithë Shqipërisë


me gjuhën kryepeshkopit të gjithë Shqipërisë

Faqe 20

Regjisori Osman Mula, artisti semiotik, shumëdimensional

Osman Mula artisti i madh i televizionit

Nga: Qamil Gjyzezi faqe 8



20 vjet nga shembja e simboleve Komuniste

Ditë të stuhishme

Nga Kiço Kostenja Faqe 13

Në BRENDËSI

Miliona Mace

Tregim nga Wanda GAG

faqe 4

"Urtësi nga Reka e Keqe"

Studim nga Prof. Sejdi Berisha

faqe 9

Vepra absurde e Danil Harms

Studim nga Klodiana Dani

faqe 17

A duhet të bëhet Paçolli president?

Opinion nga Prof. Dr. Fadil Maloku

faqe 21

Poezi

Nga Qazim D Shehu, Pirro Loli, Ferik Ferra, Spiro Thomara dhe Miljanov Kallupi

faqe 5-14

Tifozat Kuq e Zi kundër Konsullit Grek

Nga: Ilr Hoxha

faqe 23

UNIVERSITETI KRISTAL
UK

MREKULLIA E NATYRES SHQIPTARE!

Cajthiza
Uji Natyral

EURO KLEDI

Tregtojmë goma të markave:
PULSA, MICHELIN, GOODYEAR, KUMHO, DESAKA.
Adresa: Ura e Dajllentit, km.0, përballë Kolegjit "Tuna", Durrës.
Cel: 0682042182 / 0682044439

Gjeni kafënë tuaj ideale

Cel.: +355 68 20 27 067
+355 65 20 62 309
email: lltushaj@gmail.com

Kote si gazetar dhe publicist, por edhe lëvruer i poezisë, tregimit, novelës, etj

KUR JE SHKRIMTAR, KUFIJTË E

“Andon Kote është i vetmi që mundi t’i riprodhonte me saktësi maksimale ngjyrat, efektet, emocionet apo imazhet e përvojës së tij personale gjatë baticave dhe zbaticave nëpër të cilat kaloi jeta e tij.”



Shumica e njerëzve janë të mendimit se të jesh shkrimtar është diçka sa e bukur, aq edhe interesante. Pak më tej se ky koncept, unë do të shotoja se të jesh shkrimtar më shumë se gjithçka tjetër është fat. Shkrimtari Andon Kote, i cili u bë anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë që nga ditët e para të krijimit të saj, ndoshta do ta shijonte me të vërtetë mendimin tim. Por, ndonëse jubileu i 80-vjetorit të lindjes së tij qe jo më larg se një zgjatje dore, fatkeqësisht ai nuk arriti ta gëzojë atë. Jeta e tij, e cila ka shkelur më tepër mbi gjembat se sa mbi petalet e trëndafilave, u kthye instinktivisht në bojë të artë mbi fletët e bardha të gati njëzet librave.

Natyrisht, Kote nuk është i vetmi shqiptar, babai i të cilit u detyrua të ulej në prehrin e akullit të mërgimit, apo i vetmi përmetar që në moshë të mitur u pajtua shërgert për të mos ndërprerë ekzistencën fizike të vetes dhe familjes ku bënte pjesë. Ai, ndër të tjera, nuk është as i vetmi patriot që u bë shpirt e trup me luftëtarët shqiptarë për të luftuar me armë në dorë nazifashistët dhe për të ndaluar qëllimet pushtuese të tyre. Por, Andon Kote është i vetmi që mundi t’i riprodhonte me saktësi maksimale ngjyrat, efektet, emocionet apo imazhet e përvojës së tij personale gjatë baticave dhe zbaticave nëpër të cilat kaloi jeta e tij.

Për ta bërë realitet ëndrrën e të qenit shkrimtar, përkrah talentit, Kotes i erdhi në ndihmë jo vetëm edukimi shkollor që ai fitoi në Insitutin Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani” e më pas në Akademinë Ushtarake, por edhe përvoja e punës si gazetar, e më pas si sekretar kolegji dhe kryeredaktor i gazetës “Luftëtari”, ish organ i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë. Shkrimtari ynë i mirënjohur Nasho Jorgaqi e mbështet idenë e pasur me eksperiencë të këtij talenti: “Andoni kishte ardhur nga radhët e Brigadës së Parë Sulmuese dhe sillte prej andej një pasuri të madhe ngjyrash e emocione, që çdo krijues ia kishite zili.” (Nasho Jorgaqi, Shpërblimi, fq. 8). Më tej, nga përvoja e Kotes kanë përfituar edhe shumë gazeta e revista bashkëkohore që nga Shqipëria, Kosova e deri këtu në diasporë, të cilat duke botuar shkrimet e tij i kanë afruar lex-

uesit jo vetëm një emër të njohur e të respektuar në fushën e gazetarisë por, nëpërmes penës së tij, edhe trajtime problemesh me një këndvështrim sa të mprehtë aq edhe të guximshëm. Pavarësisht se Kote gjatë jetës së tij e identifikoi veten kryesisht si gazetar dhe publicist, ai qe edhe lëvruer i poezisë, tregimit e novelës, etj. Faktikisht, poezinë e parë e pati botuar te “Letrari i ri” që në vitin 1949, vetëm një vit pas botimit të reportazhit të tij të parë në gazetën “Bashkimi”. Ashtu si për shumicën e krijuesve edhe për Koten impulset e tij të para poetike nxorën shkëndija premtuese. Ato shkëndija u shndërruan në një galaktikë që ngjizej me një dashuri të shqetësuar dhe një shqetësim dashuror për Shqipërinë e tij. Ja si i foli botës së tij të brendshme me poezinë “Ç’t’i jepja tjetër”, e cila është edhe titulli i njërit prej librave të Kotes:

I dhashë Shqipërisë,
Fëmijërinë, rininë, dashurinë!
Tani po i jap modestinë dhe pleqërinë.
Të gjitha këto ia thashë
Ca në letër, ca në jetë... (faqe 23).

Kote do të ishte i pari që me modestinë e tij do t’a mohonte çdo tentativë për t’u vetëkonsideruar si poet i madh. Lavdërimi i vetes nuk qe kurrë një prej cilësive jetësore të tij. Duke qëndruar në distancën që ai mendoj se do të dëshironte të qëndroja, vargjet e mësipërme nuk i citova për t’i paraqitur lexuesit një poezi me vlera të mëdha artistike, por më tepër për të ilustruar raportin Atdhe-Njeri brenda shpirtit të pastër të Anton Kotes. Ai, në formën e vet dhe me mundësitë artistike që kishte, i hodhi me krenari idetë, ndjenjat, sakrificat apo konfliktet e brendshme që përjetoi në faqet e çmuara të letërsisë shqipe. Këtë privilegj nuk e gëzojnë të gjithë njerëzit. Pjesa dërmuese e popullatës, ose mundohet të gjejë veten te prodhimtaria letrare e atyre që kanë aftësi për të shkruar, ose në mënyrë verbale mund t’i ndajnë ato me një rreth tepër të ngushtë njerëzish. Parë nga ky kënd i fatit njerëzor, evidentialisht diferenca midis shkrimtarit dhe jo shkrimtarit mbetet e çuditshme.

Vetëm këto dhjetë vitet e fundit këtu në Amerikë Kote ka shkruar dhe botuar 14 libra. Një prodhimtari kjo për t’u lakmuar nga çdo shkrimtar shqiptar apo i huaj. Por, në vend që të shkonte më shpesh me pushime, të blinte të tjera kostume të shtrenjta, të bëhej babaxhan dhe frekuentues i kafeneve apo thjesht të tërhiqej nga jeta e vramendjes, ai preferoi të shkruante dhe vetëm të shkruante.

Njëri prej fryteve të punës së Kotes mbetet përpjekja e tij për të vënë në pah punën e të tjerëve në letërsi. Kote jo vetëm që asnjëherë në jetën e tij nuk u mundua të fuste grindje apo pakënaqësi midis miqve e kolegëve të tij shkrimtarë, por në të kundërtën ai i vuri të gjitha aftësitë e tij në shërbim të promovimit të krijimtarisë letrare shqipe ashtu edhe letërsisë së huaj. Ai i deshi dhe i respektoi kolegët e tij për atë që bëjnë në letërsi dhe jo për atë që ai do të dëshironte të kishin bërë. Të dedikosh kohën, ndjenjat, respektin, përkushtimin dhe paratë e pakta të pensionit për letërsinë dhe krijuesit e saj, siç bëri Kote, do të thotë fisnikëri, madhësi dhe pavdekësi në mendjet dhe zemrat e shumë njerëzve.

Për evidencë tekstuale, e cila mund t’i japë lexuesit një ide më të qartë se si shpirti i Andon Kotes bleronte vetëm respekt dhe dashuri shoqërore për atdheun dhe kolegët e tij, po afrojmë tekstin pa ndryshime të një letre, të cilën zoti Andon Kote e pat adresuar për tek unë vitin që kaloi:

I dashur Gjekë Marinaj,

Jam i bindur se jeni mirë me shëndet si ju ashtu edhe familja juaj, sepse unë i lutem të Madhit Zot që shokëve dhe miqve të mi, si jeni edhe ju, t’u japë jo vetëm shëndet, por edhe gëzime, lumturi e frymëzim. Dhe mua, Zoti i plotfuqishëm më dëgjon, sepse ashtu siç kam flokët e bardhë, kam edhe zemrën—ndonëse 78-vjeçare.

Po të dërgoj librin tim më të fundit që e kam titulluar “Shpërblimi”. Unë si autor kam shkruar vetëm 20-rreshta, ndërsa të 128 faqet e tjera janë shkruar e mbushur nga lexuesit e shkrimeve të mijja. E kam për nder që në faqen 110 të kem edhe një nga letrat tuaja.

Më së shumti si mik që të kam, por pse jo edhe si udhëheqës i Shoqatës sonë të nderuar të Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë po të njoftoj si vijon:

Pas një muaji do të merrni në dorë librin tim të fundit për sivjet, e ndoshta të fundit për kohën që do të jem gjallë. Këtë libër e kam titulluar “Me mendimin tek Atdheu” dhe e kam ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, kam vënë disa vjersha të zgjedhura për Atdheun nga poetët tanë më të mirë si p.sh. Pjetër Budi, Naim Frashëri, Andon Zako Çajupi, Gjergj Fishta, Sali Butka, Hil Mosi, etj.. Në këtë pjesë kam vënë edhe poezinë tuaj titulluar “Shqipëri,” e cila më duket se është e përshtatshme si nga atdhedashuria ashtu edhe nga arritja artistike. Pjesën e dytë e kam me skica, kujtime e reportazhe nga të mijat, për njerëzit që kanë vdekur, janë vrarë apo që momentalisht jetojnë në Kosovë, me të cilët kam patur fatin të kem njohje e shoqëri.

Gjekë, Një kopje të librit në fjalë, po ja nisi sot edhe Naumit Priftit në Nju Jork dhe një tjetër të vëllait të tij në San Diego, Peter Priftit. Ju dhe këta dy shokë, jeni nga shokët e mi më objektivë, më të sinqertë e me gjykime më të përparura për kohën që jetojmë, jo vetëm për sa i për-

ket letërsisë e artit, por edhe problemeve të tjera të mëmëdheut dhe të jetës së diasporës sonë.

Përqafime,
Andon Kote
(Fort Lauderdale, Florida)
15/05/2003

Dashurinë, respektin dhe nevojën komunikuese me atdhetarët dhe atdheun Kote e ka shfaqur në shumicën e librave të tij. Kur je shkrimtar, kufijtë e gjithësisë zgjerohen para teje. Kote, për të lënë sa më shumë hapësirë për një fllad real dashurie dhe malli për gjithkënd dhe gjithçka që ka të bëjë me njeriun, veçanërisht me shqiptarët, ka trokitur pa ndroje në maksimumin e kapacitetit letrar të tij. Ja si e ka formuluar poeti Dritëro Agolli mendimin e tij për Koten: “Në librat e fundit të Andon Kotes ndjehet dukshëm malli i një mërgimtari për atdheun, për njerëzit, për tokën, për gurët dhe drurët dhe të bëhet sikur autori këndon me vete vargjet e Naimit...”, Dritëro Agolli, Shpërblimi, fq. 6).

Nga që kostoja e botimit është disafishuar këto vitet e fundit si në Amerikë si në Shqipëri, Kote pranoi ndihmën sponsorizuese të dashamirësve të tij dhe të letërsisë shqipe. Falë respektit që gëzoi duke filluar nga njerëzit e thjeshtë e deri te ata më të respektuarit e komunitetit, siç është z. Ekrem Bardha, Kote mundi të shkruajë ato që deshi, pa pasur nevojë të bëjë kompromise të pakënaqshme me botues të ndryshëm. I tillë është libri me titull “Tungjatjeta Amerikë”, të cilin ia ka sponsoruar, siç thamë, botuesi i Gazetës “Illyria” z. Ekrem Bardha. Këtë vepër, autori ia ka kushtuar me dashuri dhe mirënjohje atdheut të tij të dytë, Amerikës, me rastin e 225 vjetorit të Pavarësisë. Me këtë urim shqiptar Kote shfrytëzoi rastin të bëhet shprehës i ndjenjave të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Amerikë. Libri që përmban reportazhe, artikuj, letërkëmbime dhe meditime nga jeta në Amerikë, hapet me poezinë plot ndjenja që Kote e ka shkruar ditën a ardhjes në Amerikë (6 shkurt, 1995):

Kapërceva rrebeshe e shtrëngata,
Rrugë të mundimshme dhe të gjata,
Erdha tek ty një mëngjes me brymë,
Të çlodhem pak, të mbushem me frymë!

Në librin me titull “Grimca të arta nga letërsia dhe arti” Kote ka mbledhur, si blea nektarin, mendimet gjeniale të disa prej figurave më të shquara të letërsisë botërore. Aty komunikojnë me Koten lexuesin e tij, shkrimtarë, këngëtarë, dramaturgë, muzikantë, poetë, piktorë e shkencëtarë. Kote me modestinë e tij që e pati veti të përhershme i quan “Grimca Arti” duke ja lënë lexuesit ta zbulojë për vete se ato që ai quan “Grimcat” janë një fond i artë, mbajtur dhe veshur me emocione të ndezura dhe me mendime të mençura që shkruhen lirshëm, që radhiten me kujdes, që ndriçojnë...

Në shtator të vitit 2002, Kote boton një tjetër libër “Rreth Flamurit të Përbashkuar”. Në faqen e parë shënon: “Këtë libër modest ia kushtoj Flamurit Kuqezi, simbolit të kombit shqiptar me rastin e 90-vjetorit të ringjalljes së tij. Në të 140 faqet e librit vlerësohet në kulm patriotizmi së bashku me luftën dhe përpjekjet e shqiptarëve për ta lartësuar kombin e tyre gjatë shekujve. Në këtë vepër ka edhe shumë poezi të ndjera siç është kjo që pason:

GJITHËSISË ZGJEROHEN PARA TEJE

O flamur i kuq me shkabë
Me dy krerë në përgjim:
Njëra sheh nga kemi ardhë,
Tjetra para, në marshim!

Përveç poezisë, në këtë libër, do të veçoja reportazhin me titull "Lule e bukur pors dielli", të cilin Kote, po ashtu, e pat shkruar gjatë krenimit të 28 Nëntorit. Frymëzimi i kishite ardhur, pasi ai kishte pranuar ftesën miqësore të një familjeje shqiptare me banim në qytetin Fort Lauderdale. Aty Kote po dëgjonte ca këngë të vjetra mërgimtarësh në një pajisje elektronike së bashku me mikpritësit e tij. Kënga që ia mbingarkoi zemrën vargëzonte pak a shumë kështu:

Lule e bukur pors dielli,
Kush të mbolli ty kështu?
Më ka mbjell imzot prej qiellit
Për të ndritur mendt e tu!


I magjepsur nga vargjet e kësaj kënge, Kote vë në qendër të reportazhit idenë se si shqiptarët e kanë kaluar nga njëri brez tek tjetri këngën shqiptare. Ai shkruan dhe se si i zoti i shtëpisë ku ai ishte mik i tregonte atij se atë kasetë e kishte kujtim nga gjyshja dhe se me të largonte ngapak mërzinë kur e përvëlonte në gjoks malli për Shqipërinë. Kote poetizon se Shqipëria është pors dielli dhe se ajo është e krijuar nga vetë

dora e Zotit.

Ashtu siç i takon çdo shkrimtari shqiptar, Kote nuk e ka harruar Kosovën e tij të dashur. Në fakt, librin e tij "Kosovës Martire", i cili përmban pjesërisht poezi dhe disa skica, e dërgoi (të gjithë tirazhin) falas në Kosovë. Lënda e këtij libri mbart botimet e një periudhe 3-vjeçare (1996-1999) të ngjarjeve në Amerikë, Shqipëri, Kosovë, Zvicër, Francë, Belgjikë e Turqi. Në këtë vëllim gjejmë një numër të mirë skicash që bëjnë fjalë për luftën e popullit martir kosovar për të fituar lirinë dhe pavarësinë e grabitur prej gati një shekulli. Njëkohësisht, Kote nderon edhe ushtrinë çlirimtare të Kosovës, që aq trimërisht i ka dalë për zot popullit të vet. Gjithashtu, demonstratave dhe mbështetjes së diasporës sonë në të mirë të popullit kosovar, pa lënë pas dore administratën e Klintonit dhe Amerikën, Kote u ka dhënë nota të larta vlerësimi. Për këtë libër shkrimtari dhe kritiku Dalan Shaplo është shprehur: "Poezitë dhe skicat e këtij libri janë vërtet të botuara, por sa herë lexohen, aq herë ndjehet freskia e tyre, ëmbëlsia e tyre dhe aq herë tingëllojnë aktuale. Aty ka shkruar pena dhe dora e Andonit, por ato kanë dalë nga zemra dhe shpirti i tij atdhetar, nga mendja e tij krijuese, nga gjuha e tij letrare dhe nga ndërgjegjja e tij e pastër, nga dashuria e tij e zjarrtë për Kosovën martire!" Dalani ka të drejtë. Kote e desh Kosovën jo vetëm se kosovarët janë shqiptarë, por edhe se ata qenë të pafajshëm e deri në fund

njerëzorë në luftën dhe aspiratat e tyre për liri dhe pavarësi.

Do më duheshin faqe të tëra për të mbuluar qoftë edhe përciptas pasurinë e librave të shumtë që ka shkruar miku im Andon Kote. Kështu, nga që projekti im ka mundësi të kufizuara, po e pranoj para vetes dhe lexuesit këtë limit. Por e ndjej se puna ime në këtë shkrim nuk do të mbetet e kënaqshme sikur të mos ia dedikoja dy fjalë edhe librit "Dallgëve të ndjenjave", të cilin Kote e botoi pak muaj pas ngjarjeve të 11 Shtatorit të vitit 2001. "Dallgëve të ndjenjave" nga fillimi deri në mbarim është një kushtrim mobilizimi për të luftuar që në embrion planet e terroristëve ndërkombëtarë dhe për t'u vënë krahë për krahë me Amerikën kundër çdo terroristi çnjerëzor që përpiket të mbjellë kudo gjak, vdekje, errësirë e regres. Ky libër të ngjall emocione akoma pa e hapur atë, që nga kopertina, ku një zjarrfikës njujorkez është duke shpëtuar prej flakëve një fëmijë dhe duke u munduar ta largojë atë nga Kullat Binjake, asokohe në rrënim e sipër, të këtij qyteti. Piktori i famshëm rus K.P. Bryullovi (1799-1852) një herë bëri korrigjime në skeçin e njërit prej studentëve të tij. Studenti, duke vështruar me çudi skeçin e tij të transformuar, tha: "Ju thuajse s'prekët asgjë në projektin tim, megjithatë ka ndryshuar krejtësisht." Bryullovi u përgjigj: "Te



thuajse asgjëja është pika ku fillon Arti". Thënia e Bryullovi është e vërtetë edhe për jetën e veprën e Andon Kotes. Ai filloi të thuajse asgjëja dhe u shkri nëpër faqet e gati 20 librave për të arritur te diçkaja. Aty, në veprat që le pas, gjendet përjetësia e çdo krijuesi të vërtetë. Në librat e Kotes do e gjejmë ne dhe brezat e ardhshëm të lexuesve shkrimtarin që mbi të gjitha qe një njeri i dashur, i sjellshëm, modest dhe i ndershëm me të gjithë. Pra, të jesh shkrimtar në një farë mënyrë je i pavdekshëm. Pavdekësia është fat...

*Marinaj është pedagog i letërsisë bashkëkohore në "Richland University" në Dallas, SHBA.

Haiku, një traditë e mrekullueshme mendimi japonez

Poetët më të njohur të haikut klasik

"Po çfarë është një haiku klasik? Haiku është një poezi përqëndrimesh dhe me karakteristika shumë të sakta që lidhen me formën, në rradhë të parë me rrokjet dhe vargjet. Përbëhet nga tre vargje me 17 rrokje duke i ndarë ato në 5/7/5. Për nga përmbajtja fillimet e tij përkohë me natyrën, ndjenjat, emocionet e poetit ndaj natyrës, por sot përmbajtja ka marrë hapësira më të gjera dhe përfshin gjithçka që ka të bëjë me jetën tonë."

Nga Arjan Kallço

Këto ditë në një simbiozë apo telepati asoci-mesh të ideve, më lindi dëshira të shkruaja disa haiku, por pa e ditur se kishte një koincidence me Javën japoneze të kulturës. Prej disa vitesh marr pjesë në një konkurs haiku në Itali dhe disa javë më parë, më vjen mesazhi ftesë që të jem përsëri mes shumëpoetëve të haikut, i cili është një formë poezie që nënkupton një mënyrë disi ndryshe të filozofisë, me qëllim që ta përmbledhë, unë do t'i quaja lloj maksimash, me pak fjalë një mendim tepër të thellë dhe me një kuptim tepër ngasës drejt meditimit. Po çfarë është një haiku klasik? Haiku është një poezi përqëndrimesh dhe me karakteristika shumë të sakta që lidhen me formën, në rradhë të parë me rrokjet dhe vargjet. Përbëhet nga tre vargje me 17 rrokje duke i ndarë ato në 5/7/5. Për nga përmbajtja fillimet e tij përkohë me natyrën, ndjenjat, emocionet e poetit ndaj natyrës, por sot përmbajtja ka marrë hapësira më të gjera dhe përfshin gjithçka që ka të bëjë me jetën tonë.

Ka dy variante haiku që lidhen me subjektin :
1. njëri prej vargjeve shtron argumentin i cili zgjerohet dhe mbyllet në dy vargjet e tjera
2. trajton argumenta të ndryshëm, por që janë në harmoni apo kundërshti mes tyre Kohët e fundit ka edhe një rrymë tjetër të shkruari të haikut,

por që nuk i qëndron rregullave dhe karakteristika të tij strikte të përcaktuara nga vetë japonezët dhe që ka përhapje në Perëndim. Të shkruash haiku do të thotë të vëzhgosh botën me një sy të kujdesshëm, tepër të fiksuar pas ngjarjes në momentin e kryqëzimit të vëmendjes me faktin. Përpunimi i sinjaleve që kap syri dhe që më pas lindin dhe filtrohen në mendje, tregon sesa ajo është e prirur të nxjerrë ekstraktin e duhur filozofik. Ngjarja na shtyn ta kapim thelbin e një ndodhie për të cilën jemi dëshimtarë, thelbin e një përvoje ndoshtatë papërsëritshme tek të tjerët, edhe sikur të jenë shumë sy që ta kapin ndodhinë, jo të gjithë do ta shprehin njëllë, qëndrën e një emocioni që vetëm në atë çast shkakton vetëtimën e duhur për reagim. Pra me pak fjalë është një shkollë e madhe jete dhe reflektimi për njeriun, që nëse do ta shprehim me terma të tjerë, do të ishte filozofia imediate e ngjarjes së ditës, e një njeriu të cilit nuk i ndodh shpesh të bëjë spekulime të mendjes. Po ta shohim nga ana historike, haiku lindi në Japoni në shekullin e 17-të, por që prejardhjen e ka nga Tanka që ka në vetvete 31 rrokje të ndara në 5 vargje. Poezitë tanka i kanë fillesat e tyre që në shekullin e 4-të dhe duke eliminuar dy vargjet e fundit, përfitohet haiku me tre vargje. Antologjia e parë e poez-

isë japoneze e ka zanafillën në shekullin e 8-të me 20 volume dhe rreth 4500 poezi me stil të ndryshëm. Në disa vende të botës mësohen rregullisht në kurse teknikat e haikut. Në vendlindjen e haikut llogaritet se rreth 10 milionë japonezë e praktikojnë atë ose e shprehur në përqindje rreth 10% e saj. Haiku është një traditë kombëtare japoneze dhe që çdo ditë, në të gjitha revsitat dhe gazetatat japoneze ka një rubrikë që i dedikohet atij. Midis poetëve më të njohur të haikut përmendim : Basho, Buson, Issa, Chiyo, Shiki, Uchida, Kyoshi, Jack Kerouac. Më poshtë po sjell 1 poezi haiku sipas karakteristika klasike të tij.

Një buzëqeshje
Në buzët plot me vesë
Rilind gëzimin

Degës së thyer
I therri fort në zemër
Fryma e jetës

Një puthje e trisht'
Në gushën e vashës yll
Lajmëron stuhi

Bryma mbi çati
Zbardh prej ditës së agut,
I ndruhej natës

Bora me hojna
Tek po binte butësisht
Mbulonte zgjyrrën

Libri i heshtur
Sot dergje i vetmuar
Mbi barin tharë

Jeta nuk jeton
Kur shpirti në arrati
Prapa nuk shikon

Një këngë e re
Në ajrin e ndezur flak'
Gëlon në mendje

Dora e brishte
Mes flokësh shpupurisur
Zgjoji shkëndija

Shiu bredharak
Mes gjetesh lozonjare
Gjeti folezën